

VENDIM
Nr. 56, datë 29.1.2025

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES ME SHKËMBIM LETRASH NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
AGJENCISË JAPONEZE TË BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR, PËR
NDRYSHIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS JAPONEZE PËR
BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT
“PËRMIRËSIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMEVE PËR TIRANËN E MADHE”,
RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 9964, DATË 24.7.2008**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes me shkëmbim letrash ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Japoneze të Bashkëpunimit Ndërkombëtar, për ndryshimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar, për financimin e projektit “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve për Tiranën e Madhe”, ratifikuar me ligjin nr. 9964, datë 24.7.2008, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



Agjencia Japoneze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar

Data: 9 dhjetor 2024

Ref. nr. JICA (BK) 202412060002

Sh. së Tij Petrit MALAJ,
Ministër i Financave,
Republika e Shqipërisë

Lënda: Amendamenti i Marrëveshjes së Huasë për "Projektin e Përmirësimit të Sistemit të Kanalizimeve për Tiranën e Madhe" (ndërmjet Bankës Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (pasuar nga Agjencia Japoneze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar në tetor 2008) dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, datë 30 qershor 2008 (Marrëveshja e Huasë nr. ABA-P3): Rialokimi i të ardhurave të huasë.

Shkëlqesia Juaj,

Duke iu referuar letres suaj të datës 26 nëntor 2024 (ref. juaj nr. 7026/6 Prot.) në lidhje me kërkesën për rialokimin e të ardhurave të huasë, me anë të kësaj ne biem dakord që:

1. Tabela e Alokimit të të Ardhurave të Huasë, e cila është pjesë e Seksionit 1 të Skedulit 2 në Marrëveshjen e Huasë së cituar, do të zëvendësohet sipas kësaj letre bashkëlidhur.
2. Ky Amendament do të hyjë në fuqi në datën kur JICA njoftohet se çdo procedurë e nevojshme për efektshmërinë e tij në Republikën e Shqipërisë, ka përfunduar.
3. Kjo Letër nuk do të interpretohet se autorizon ndonjë ndryshim përveç atij të përmendur më sipër.

Me respekt,

Nënshkrimi
Hajime FUKUDA
Kryepërfaqësues
Zyra e Ballkanit JICA

Për dënim: Znj. Enkelejda MUÇAJ, Zëvendës Ministre e Infrastrukturës dhe Energjisë
Z. Klevis JAHAJ, Drejtor i Përgjithshëm i AKUM-it
Z. TOYAMA Kei, Drejtor i Përgjithshëm, Departamenti i Lindjes së Mesme dhe Evropës, JICA

Skeduli 2

Alokimi i të Ardhurave nga Huaja

Seksioni I. Alokimi

Kategoria	Shuma e huasë Alokuar	% e Shpenzimeve për t'u financuar
(A) Punimet Civile dhe Prokurimi i Mallrave	8,167,995,700	100%
(B) Shërbimet e Konsulencës	2,626,004,300	100%
(C) Interesi gjatë ndërtimit	232,000,000	-
i) në lidhje me (A) dhe (E)	231,000,000	
ii) në lidhje me (B)	1,000,000	
(D) Kontingjencat	0	-
(E) Tarifa e angazhimit	95,000,000	-
Totali	11,121,000,000	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BORXHIT SHTETËROR
DREJTORIA E MARRËVESHJEVE DHE SIGURIMIT TË NDIHMËS SË HUAJ

Nr. 7026/C
prot.

Tiranë, më 26/11.2024

Lënda: Mbi Projektin “Përmirësimi i Sistemit të Kanalizimeve të Tiranës së madhe”.

AGJENCISË JAPONEZE PËR BASHKËPUNIMIN NDËRKOMBËTAR
Nibancho Center Building,
5-25, Niban-cho, Chiyoda-ku, Tokyo
102-8012, Japan

Referuar Marrëveshjes së Huasë (Nr.ABA-P3, datë 30 qershor 2008), ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar, për Projektin “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve për Tiranën e madhe”.

Me qëllim finalizimin e suksesshëm të aktiviteteve që do të financohen nga kjo marrëveshje nëpërmjet kësaj shkrese ju përcjellim kërkesën e palës shqiptare si vijon:

- rialokimin e fondeve për shërbimin e konsulencës nga Kategoria (A) në Kategorinë (B) në vlerën 989,151,240 JPY, sipas tabelës së rialokimit si më poshtë:

Kategoria	Shuma fillestare e huasë (JPY)	Shuma e alokuar e huasë (JPY)	Shuma e disbursuar (JPY)	Shuma e mbetur pa disbursuar (JPY)	Alokimi që propozohet (JPY)	Shuma pas alokimit (JPY)
(A) Punimet civile dhe prokurimi i mallrave	9,238,000,000	9,157,146,940	6,632,520,041	2,524,626,899	-989,151,240	1,535,475,659
(B) Shërbimet e konsulencës	1,091,000,000	1,636,853,060	1,636,852,577	483	+989,151,240	989,151,723
(C) Interesi gjatë ndërtimit	253,000,000	232,000,000	214,464,284	17,535,716		17,535,716
i) në lidhje me (A) dhe (E)	252,000,000	231,000,000	213,494,676	17,505,324		17,505,324
ii) në lidhje me (B)	1,000,000	1,000,000	969,608	30,392		30,392

(D) Zërat e paparashikuar	462,000,000	0	0	0		0
(E) Tarifa e Detyrimit Financiar	77,000,000	95,000,000	90,290,991	4,709,009		4,709,009
Totali	11,121,000,000	11,121,000,000	8,574,127,893	2,546,872,107		2,546,872,107

Kjo letër së bashku me letrën tuaj të përgjigjes do të përbëjnë marrëveshjen me shkëmbim letrash të marrëveshjes së huasë (datë 30 Qershor 2008, Nr. APA-P3), ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar për projektin “Përmirësimi i Sistemit të Kanalizimeve për Tiranën e Madhe”.

Ky ndryshim hyn në fuqi pasi pala shqiptare do të njoftojë Agjensinë Japoneze të Bashkëpunimit Ndërkombëtar - JICA për përfundimin e procedurave të brendshme ligjore.

MINISTËR

Petrit Malaj

